

VENDIM
Nr. 37, datë 24.1.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM – ASFALTIM I SEGMENTIT RRUGOR ‘TAULLA SINANI’–‘ESMA DERVISHI’ NË LAGJEN ‘XHEVDET NEPRAVISHTA’, LUSHNJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim – asfaltim i segmentit rrugor ‘Taulla Sinani’–‘Esma Dervishi’ në lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, Lushnjë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “trual” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 785 986.50 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 785 986.50 (shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK “SISTEMIM ASFALTIM I SEGMENTIT RRUGOR ‘TAULLA SINANI’-‘ESMA DERVISHI’ NË LAGJEN ‘XHEVDET NEPRAVISHTA’ LUSHNJË”

NR.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										TRUALL			NDËRTESË			VLERA TOTALE (€)	SHËNIME (Kufizime hipotekare, banorë në pajtim etj.)
	Emri	Adresa	Mbiemri	Fshat ose Qyte	Z. Kadastrale	Nr. i parcelave	Lloji i parcelave	Sipërfaqja Totale	Aer (m ²)	Trrall (m ²)	Ndërtues (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Gjatësi (shk./m ²)	Vjeri (shk)	Sipërfaqja (m ²)	Gjatësi (shk./m ²)	Vjeri (shk)		
1	VERGJIL HATKOHI	AVNO BUD	SINANI SINANI	LUSHNJE	8571	26/110	TRUALL	270	0	270	138	26	191	13.0	9709	126217	0.0	0	0	126217	Sok. F: Gndet banorë 3 katëshe, sip. e katit I 138 m ² , kat II 145 m ² . Ndërtesa me përkat. konformuar me shërbim nr. 8464/1 prov., datë 17.10.2023.
2	SHIPRESA ALAKETA KHELMIND	MUSTAFA XHEMAL XHEMAL	SINANI SINANI SINANI	LUSHNJE	8571	26/107	TRUALL	1412	0	1412	84			25.0	9709	242725	0.0	0		242725	Sok. E: Vendi K.K. prurës (banorë 1- katëshe). Ndërtesa me përkat. konformuar me shërbim nr. 8464/1 prov., datë 17.10.2023.
3	FATOS LUSJETA	HASAN RIZA	SHEHU SHEHU	LUSHNJE	8571	26/4	TRUALL	144	0	144	48	27	84	7.8	9709	73730	0.0	0	0	73,730.20	Sok. E: Eje legaliteti nr. 99999, datë 26.1.2017, goditje banorë i katit I, sip. ndërtimi 48 m ² , sip. parcelë 144 m ² . Ndërtesa me përkat. konformuar me shërbim nr. 8464/1, prov., datë 17.10.2023.
4	PETRO VALLI	REXHEP RAMAZAN	SINJARI SINJARI	LUSHNJE	8571	26/254	TRUALL	337	0	337	169			20.7	9709	200976	0.0	0	0	200976	Sok. F: Gndet banorë 5 katëshe, sip. e katit parës ekonomik 169 m ² , sip. kat I banorë 194 m ² , sip. kat II banorë 109 m ² . Ndërtesa me përkat. konformuar me shërbim nr. 8464/1, prov., datë 17.10.2023.
5	HIQMET QEMAL	PASHO PASHO	META META	LUSHNJE	8571	26/150	NDËRTESË	66	0	0	66	0	0	0.0	0	0	8.7	0	140338	140338	Konformuar nga ASHC-ja
VLERA TOTALE																645649			140338	785986.50	